

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal, me gjyqtarin individual Mustaf Tahiri dhe me procesmbajtësen Genta Jashari, në lëndën penale kundër të akuzuarve H.H. dhe S.H. të akuzuar sipas propozimkuzës së ish Prokurorisë Komunale në Ferizaj PP/IL.nr.839-03/12 të dt.08.10.2012 për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.1 lidhur me par 1.4 dhe nenin 23 të KPK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datën 06.07.2016, në prezencën e Prokurorit të shtetit Visar Musa, të dëmtuarit R.B. si dhe të akuzuarve, me datë 06.07.2016 publikisht shpalli dhe komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarve:

1. **H.H.**, data e lindjes.... , nga fshati e komuna Ferizaj, nga i ati Xh. dhe e ëma T., e gjinisë Sh., i martuar, prind i tetë fëmijëve, i pa punë, gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr.personal
2. **S.H.**, data e lindjes...., nga fshati e Poshtem komuna Ferizaj, nga i ati H. dhe e ëma S. e Gjinisë Z., i pa martuar, student, punëtor në punëtorinë “.....”, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr.personal

Në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPK-së,

REFUZOHET AKUZA

Me datë 30.05.2012, rreth orës 18.30, në fshatin Neredime komuna Ferizaj, në bashkëkryerje i kanë shkaktuar lëndim të lehtë trupor të dëmtuarit R.B., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje që kishte ndodhur në mes të pandehurve dhe vëllaut tjetër të të dëmtuarit SH.H., i dëmtuari afrohet me qëllim të shikoj se çka po ndodh aty, atëherë i pandehuri S.H. e godet direkt në fytyrë dhe pas tij i pandehuri H.H. e kap për fyti duke shtyrë me ç`rast e godet për kamioni ku nga këto goditje i dëmtuari merr lëndime të lehta trupore dhe atë plagë shqyese-ndrydhëse në gishtin e parë dhe të dytë të dorës së majtë të cilat lëndime rezultojnë me pasoja të përkohshme të shëndetit,

Me që për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.1 lidhur me par 1.4 dhe nenin 23 të KPK-së, ka arritur afati i parashkrimit absolut i ndjekjes penale.

I dëmtuari R.B., nga fshati e komuna Ferizaj, ka deklaruar se nuk paraqet kërkesë pasurore-juridike.

Shpenzimet e procedurës penale biejn në barrë të mjeteve buxhetore.

A r s y e t i m

Prokuroria Komunale në Ferizaj me propozimkuzën PP/II.nr.839-03/12 të datës 08.10.2012 e ka akuzuar H.H. dhe S.H. nga fshati e komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.4 lidhur me par 1 nënpar 4 dhe nenin 23 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj propozim akuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datën 06.07.2016, kurse prokurori i shtetit Veton Shabani në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë akuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale duke kërkuar që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe tu shqiptohet një sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjyqtari individual pasi u bind se të pandehurit kanë kuptuar akuzën, konform nenit 325 të KPPK-së të akuzuarit i ofroi mundësin të pranojnë fajësinë ose të deklarohen të pafajshëm.

Të pandehurir H.H. dhe S.H. në shqyrtimin gjyqësor nuk janë deklaruar lidhur me fajësinë duke shfrytëzuar të drejtën e tyre që të mbrohen në heshtje.

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të këtij vlerësimi vërtetohet gjendjen e fakteve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit R.B., në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se H.H. e kam vëlla ndërsa S.H. djalë të vëllaut, se me ta ka pasur mosmarrëveshje dhe i kujtohet se me shuplakë në fytyrë e ka goditur H.H., tani raportet i kanë të mira dhe më nuk kanë mosëmarrëveshje mes vete se janë pajtuar mes vete. Po ashtu i njëjti ka deklaruar se që nga viti 2000 janë ndarë nga bashkësia familjare dhe që nga atëherë jeton vetëm me nënën, guan dhe fëmijët e tij, gjithashtu edhe vëllau i tij i pandehuri H.H. jeton së bashku me familjen e tij në shtëpi tjetër 200 larg nga shtëpia e tij, të cilën dëshmi gjykata e ka vlerësuar me kujdes të veçantë dhe të njëjtën e vlerësoi si të besueshme, reale dhe objektive dhe është në përputhshmëri të plotë edhe me provat tjera që gjinden në shkresë të lëndës siq është mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko ligjor dr.M.G. nr.ref.Fe-..../12 të datës 08.09.2012.

Gjykata gjithashtu ka bërë administrimin e provave materiale dhe atë mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko ligjor dr.M.G. nr.ref.Fe-..../12 të datës 08.09.2012, ku është konstatuar se i dëmtuari R.B. ka pësuar dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Gjykata pas administrimit të provave, dëgjimit të dëmtuarit R.B. i cili ka deklaruar se me të akuzuarin H.H. e ka vëlla ndërsa të akuzuarin S.H. djalë të vëllaut dhe se me të akuzuarit nuk jeton së bashku ne një shtëpi, dhe që nga viti 2000 janë ndarë nga bashkësia familjare

dhe se i dëmtuari jeton vetëm në një shtëpi me nënën e tij, gruan dhe dy fëmijët, ndërsa i akuzuari H.H. se bashku me familjen e tij jeton në një shtëpi tjetër larg 200 metra nga shtëpia e tij.¹

Gjykata i bëri analizë veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.4 lidhur me par.1 nënpar 4 të KPK-së e cila thotë “ nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 kryhet kundër personit me të cilin kryesi është në mardhënie familjare, kryesi dënohet me së paku tre muaj deri në tre vjet burgim për veprën penale nga paragrafi 1 ose me burgim prej gjashtë muajsh deri në tre vjet për veprën penale nga paragrafi 2”.

Poashtu gjykata ka analizuar kapitullin XII të KPK-së domethëniet e shprehjeve në këtë Kod dhe në nenin 107 paragrafi 24 të KPK-së ku është përcaktuar shprehja “Marëdhënie Familjare” do të thotë mardhënia mes dy personave:

1. Që janë të fejuar ose të martuar me njëri tjetrin ose që bashkëjetojnë me njëri tjetrin pa martesë,
2. Që kanë të përbashkët shtëpinë kryesore dhe që janë të afërt të gjakut, martesës, adoptimit ose janë në mardhënie të kujdestarit, duke përfshirë prindërit, gjyshine gjyshen, fëmijët, nipat e mbesat nga vajza dhe djali, vëllezrit dhe motrat, hallat dhe tezet, dajët dhe axhallarët, mbesa dhe nipat nga vëllai dhe motra, kushërinjtë ose
3. Që janë prindër të fëmijës së përbashkët.²

Gjykata gjithashtu ka analizuar ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje ligji nr.03/L-182 në nenin 2 të këtij ligji para 1.1. Marrëdhënie Familjare konsiderohen personat nëse: 1.1.1. janë të fejuar apo ishin të fejuar; 1.1.2. janë të martuar apo ishin të martuar; 1.1.3. janë në bashkësi jashtëmartesore apo ishin në bashkësi jashtëmartesore; 1.1.4. bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët ose që bashkëjetuan në një ekonomi të tillë; 1.1.5. përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesë, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, vëllezërit dhe motrat, hallat e tezet, xhaxhallarët e dajallarët ose kushërinjtë; 1.1.6. janë prindër të një fëmije të përbashkët; 1.1.7. janë palë procedurale në një kontest nga marrëdhëniet familjare.³

Andaj gjykata pas analizimit të dispozitave të lartpërmendura nuk vërtetoi se formësohen elementet e veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.4 lidhur me par 1 nënpar.4 lidhur me nenin 23 të KPK-së, pasi që bazuar në këto për të ekgzistuar elementet e kësaj vepre penale duhet që kryesi i veprës penale dhe i dëmtuari të jenë në marrëdhënie familjare dhe të jetojnë në një shtëpi të përbashkët dhe se marrëdhëniet mes të akuzuarve H.H. dhe S.H. nuk paraqesin raport të “mardhënieve familjare” edhe përkundër faktit se i dëmtuari R.B. të akuzuarin H.H. e ka vëlla përkatësisht të akuzuarin S.H. djali të vëllaut, për faktin se për tu trajtuar se mardhënie familjare është e nevojshme të plotësohen kushtet në mënyrë kumulative (të jetojnë në shtëpi të përbashkët dhe të vjen vëllezër përkatësisht djali i vëllaut) e që kjo e para ka munguar nisur nga fakti se të akuzuarit që nga viti 2000 nuk jetojnë në një shtëpi të përbashkët pra jetojnë në shtëpi dhe familje të ndara mes vete. Andaj gjykata duke u bazuar në provat e administruara dëgjimin e të dëmtuarit R.B. duke vepruar sipas detyrës zyrtare bëri rikualifikimin e veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK-

¹ Shih deklarinimin e të dëmtuarit R.B. në shqyrtimin gjyqësor.

² Shih nenin 107 par.24 të KPK-së

³ Shih nenin 2 të ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje nr.03/L-182

së, pasi që gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve manifestohen dhe formësohen të gjitha elementet e kësaj veprë penale.

Pas rikualifikimit të veprës penale nga ana e gjykatës, në veprë penale në bashkërkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK-së, gjykata konstaton se vepra penale është kryer me date 30.05.2012, për të cilën vepër penale parashihet denimi me gjobë ose me burgim deri në një vit, andaj në kuptim të nenit 90 par. 6 të KPK-së ndjekja penale nuk mund të ndërmeret nëse kanë kaluar dy vite nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një vitë, ndërsa conform nenit 91 par.6 ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, në rastin konkret nga dt. 30.05.2012 kanë kaluar mbi 4 (katër) vite që nënkupton se në këtë çështje penale ka ndodhur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Andaj gjykata në kuptim të nen. 363 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

I dëmtuari R.B., nga fshati e komuna Ferizaj, ka deklaruar se nuk paraqet kërkesë pasurore-juridike.

Konform nenit 454 par.1 të KPK -së shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga arsyet e sipërcekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI
PËRGJITSHËM – DIVIZIONI PENAL
P nr. 1458/12 të dt. 06.07.2016**

**Procesmbajtësja ,
Genta
Jashari**

**Gjyqtari individual,
Mustaf Tahiri**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet ankesë në afat prej 15 dite, pas pranimit të kësaj me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.

-